

1.1.1. Rregullorja për punimin e temave të diplomës BA dhe MA

Në bazë të statutit të Kolegjit ESLG, Bordi Menaxhues i Kolegjit ESLG me 20.08.2019 nxjerr rregulloren për punimin e temave të diplomës BA dhe MA

FORMA

Letra standarde: A4.

Formati i fletave: lidhur.

Renditja: renditja nga anash majtas ose djathtas është 3 cm, ndërsa nga lartë 2,5 cm.

Shkronjat:

- Forma e shkronjës: Lloji Arial.
- Madhësia: 12 (11 pikë, regular).
- 1,25 distanca ndërmjet të rreshtave (1,25 line spacing).
- E njëjtë në të dyja anët (justify).

Letra

Letra duhet të jetë e butë përderisa vetëm mbështjellja duhet të jetë e fortë. Printimi bëhet në të dyja anët e fletës.

Lidhja

a) Punimi i diplomës BA

Punimi i diplomës BA duhet të jetë i lidhur me mbështjellës të fortë me ngjyrë të kaltërt të mbyllur. Titulli shkruhet me shkronja të argjendit.

b) Punimi i diplomës MA

Punimi i diplomës MA duhet të jetë i lidhur me mbështjellës të fortë me ngjyrë të kaltërt të mbyllur. Titulli shkruhet me shkronja të argjendit.

Numërimi

Faqet duhet të jenë të vendosur në mes të faqes.

- Në faqen e parë nuk shënohet numri.
- Faqja tjetër fillon me numrin romak ii, abstrakti me numrin romak iii e kështu me rradhë
- Pjesa tjetër e punimit të diplomës nga Hyrja e deri në Konkluzionet duhet të jetë e shënuar me numra arab që fillojnë me numrin 1.

Madhësia

a) Punimi i diplomës BA

Punimi i diplomës BA duhet të jetë prej 50.000 - 80.000 karaktere.

b) Punimi i diplomës MA

Punimi i diplomës MA duhet të jetë prej 110.000 - 150.000 karaktere.

STRUKTURA E PUNIMIT TË DIPLOMËS

Struktura e punimit të diplomës është paraqitur si në vijim:

ABSTRAKTI

Abstrakti duhet të flas për qëllimin e studimit, metodologjinë e përdorur të hulumtimit dhe gjetjet e këtij hulumtimi. Abstrakti ka 15 rreshta dhe gjithashtu përfundë saj vendosen fjalët kyçe që nuk guxojnë të jenë më shumë se pesë.

TABELA E PËRMBAJTJES

Tabela e përmbajtjes paraqet strukturën e temës së diplomës për nga titujt që përmban.

HYRJE

Hyrja është pjesë përbërëse e temës së diplomës. Hyrja paraqet pjesën fillestare të temës së diplomës. Me hyrje autori flet për fushëveprimin e temës, problemin që kjo temë e diplomës përpiqet të zgjedh, hipotezat, qëllimin e studimit, metodat shkencore të përdorura në kuadër të temës. Hyrja përmban këto pjesë:

a) Hyrja e temës së diplomës në bachelor:

- Përkufizimin e temës së diplomës.
- Fushëveprimin dhe qëllimin e temës së diplomës.
- Pyetjen hulumtuese dhe hipotezat
- Vlerësimin e hulumtimeve të deritanishme
- Metodën e përdorur në hulumtim.
- Përshkrim i shkurtër i kapitujve të temës së diplomës.

Hyrja përmban 5 % të tërë vëllimit të temës së diplomës.

b) Hyrja e temës master:

- Problemi që ky hulumtim përpiqet t'a ndriçojë me hipotezat e përcaktuara.
- Fushëveprimin dhe qëllimet e hulumtimit.

- Pyetjen hulumtuese dhe hipotezat
 - Vlerësimin e hulumtimeve të deritanishme në atë fushë.
 - Metodatat hulumtuese.
 - Përshkrim i shkurtër i kapitujve të temës së diplomës master.
- Hyrja përmban 5 % të tërë vëllimit të temës së diplomës.

TRUPI I TEMËS SË DIPLOMËS

Trupi i punimit të diplomës përbëhet pjesa teorike, analitiko-eksperimentale dhe në fund pjesa përfundimtare.

Pjesët ndahen në kapituj dhe numërohen sipas sistemit decimal sikurse 1, 1.1, 1.1.1, 2, 2.1, 2.1.1 etj.

Pjesa teorike flet shtjellon temën nga këndvështrimi teorik dhe flet për rishikimin e literaturës në lidhje me temën e cila trajtohet në punimin e diplomës.

Pjesa analitiko-eksperimentale e punimit të diplomës është pjesa më e rëndësishme. Në këtë pjesë student përdor metodatat e hulumtimit duke u bazuar në të arriturat në teori dhe literaturën e shtjelluar. Kjo pjesë e punimit duhet të jetë e pavarur dhe objektive ku përdoren metodatat përkatëse të hulumtimit për të vërtetuar hipotezat e ngritura.

Në pjesën përfundimtare studenti krahason gjetjet e tij/saj të arritura nëpërmjet të metodës hulumtuese me gjetjet e autorëve tjerë të cilët kanë arritur tek gjetjet e ngjashme apo të kundërta të arritura me metoda të njëjta apo tjera hulumtuese.

Lista e literaturës

Në fund të punimit të diplomës duhet të vendoset literatura e përdorur. Literatura duhet të vendoset sipas abcd-së së autorëve. Referencat duhet të jenë të ndara në grupe si për shembull librat, xhurnalat, punimet në konferenca, citatat nga ligji etj. Lista e literaturës duhet të ketë minimum 10 burime të pranueshme.

Tabelat dhe grafikat

Tabelat, grafikat, skicat dhe ilustrimet tjera që janë të përfshira në tekstin e punimit të diplomës duhet të paraqiten ndaras si listë në fillim të punimit të diplomës.

Gjithashtue dhe lista e shkurtesave të përdorura në tekst duhet të paraqitet ndaras.

Shtojcat

Formulari dhe lista e anketës, tabelat analitike dhe dokumentet tjera që janë shtjelluar për temë mund të vendosen si shtojcë në fund të temës së diplomës në mënyrë kronologjike.

Deklarata për autorësinë dhe lektorimin

Deklarata

Me nënshkrimin unë siguroj se:

- Puna përfundimtare e paraqitur është vetëm rezultat i vet punës sime kërkimore
- Puna është korrigjuar në përputhje me komentet e mentorit dhe anëtarëve të komisionit. Unë kujdesem që publikimet dhe mendimet e autorëve të tjerë, të cilat përdoren në tezën time janë cituar dhe caktuar në përputhje me rregullat përkatëse të fakultetit.
- Unë jam i vetëdijshëm se plagjiatura-prezantimi i punëve të të tjerëve, ose në formën e kuotimit ose në formën e parafrazimit të literatures apo në formë grafike, të cilat përmbajnë mendimet apo idetë e të tjerëve por janë paraqitur si vetanake është e dënueshme me ligj (Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të ndërlidhura).

DEKLARATË STATUTORE

Nën përgjegjesinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë përpara ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose si pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga një person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

CITIMET

Gjatë përpilimit të punimit të diplomës duhet ndarë tekstin e autorit nga teksti që paraqet mendimet, idetë, të dhënat dhe ilustrimet e autorëve tjerë. Autori gjatë përshkrimit të definicioneve, aspekteve shkencore, informatave dhe të dhënave shkencore duhet të citojë burimin prej nga i ka marrë. Me citim autori bën me dije burimin e informatave, definicioneve dhe teorive shkencore, të cilat burime mund të vërtetohen lehtë.

Ekzistojnë disa mënyra të citimit si në vijim:

- Mënyra evropiane (në fusnotë)
- Amerikane ose forma e Harvardit (citimi në fund të tekstit të cituar i vendosur në kllapa).

VËREJTJET

Të gjitha vërejtjet vendosen në fusnotë dhe përdorin fontin Arial 10.

Vërejtjet janë dy llojesh si në vijim:

- Vërejtjet shpjeguese;
- Vërejtjet krahasuese;

Vërejtjet vendosen në fusnotë duke u vendosur fusnotat më numra arab.

Rregullat për citim

- Së pari vendoset autori i citatit, pastaj viti i botimit të asaj vepre dhe faqja prej nga është marrë (T. Jerovšek, 2006, faqe. 37).
- Nëse janë dy autorë i shënojmë të dy (T. Jerovšek dhe J. Čebulj, 1995, faqe. 125). Nëse janë tre autorë shënojmë të tre (T. Jerovšek, J. Čebulj dhe P. Jambrek, 1995, faqe. 125).
- Nëse kemi më shumë se tre autorë atëherë vendoset emri i publikimit komplet, viti i botimit dhe faqja prej nga është marrë citati nga ai publikim (Komentar ustave RS, 2011, str. 43).
- Nëse i referohemi idesë e cila gjithashtu përmendet në një publikim por nuk e marrim si citat atëherë e shënojmë (shih P. Jambrek, 2007, faqe. 123).
- Nëse citojmë një pjesë të shkruar nga një autor i parë i cili është i shënuar në një libër tjetër të autorit të dytë mirëpo ne e kemi marrë nga autori i dytë atëherë ne shkruajmë (T. Jerovšek NË: J. Čebulj, 1998, faqe. 20).
- Nëse i referohemi ligjeve atëherë aty duhet të shënojmë shkurtesën e ligjit për shembull ligji i procedurës kontestimore dhe neni i cituar (LPK, neni 34).

VENDOSJA E LITERATURËS NË FUND

Literatura në fund të punimit të diplomës vendoset si në formën në vijim:

PUBLIKIMET E PAVARURA

Së pari vendoset mbiemri me shkronja të mëdha, pastaj emir me shkronja të vogla, titulli i publikimit apo librit, vendi ku është botuar, institucioni që e ka botuar dhe viti i botimit.

Shembull:

NOVAK, Marko, Hyrje në Drejtësi. Nova Gorica: Evropska pravna fakulteta, 2010

Nëse ka më shumë se tre autorë atëherë ne e shënojmë vetëm emrin e publikimit.

Shembull:

TITULLI I BOTIMIT: nëntitulli nëse ka/ Emri i autorit të parë ... [et al.]; ur. Emri dhe mbiemri.

Vendi: Institucioni botues, viti i botimit.

Shembull:

KOMENTARI i Kushtetutës së Republikës së Sllovenisë: Plotësim - A / Matej Avbelj ... [et al.] ; ur. Lovro Šturm. Kranj : Fakulteta za državne in evropske študije, 2011

Tek burimet anonime të cilat janë raporte apo publikime të cilat nuk kanë autorë të specifikuar atëherë citimi bëhet si në vijim:

(VS, 2014) Vjetari statistikor i RK. Prishtinë: Enti Statistikor i Republikës së Kosovës, 2014.

Botimet në revista shkencore

Mënyra e referencës së botimeve në revista shkencore bëhet si në vijim:

MBIEMRI, emri, Titulli i revistës. NË: Titulli i revistës. Viti i botimit, Vëllimi i botimit, numri i botimit, faqja prej deri.

Shembull:

DALY, Mary, EU Social Policy after Lisbon. NË: Journal of common market studies (JCMS). 2006, vol. 44., nr. 3., faqe. 461-481

CITIMET NGA LIGJI

(Shkurtesa e ligjit) Titulli i ligjit. Botimi, plotësim.

Shembull:

- (LP) LIGJI penal. Gazeta Zyrtare RKS, Nr. 18/2011

PRAKTIKA GJYQËSORE

Shembull:

1. VENDIMI i Gjykatës, Nr. C-39/72-Komisioni Evropian kundër Italisë, 7.2.1973. URL: <http://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?language=sl&jur=C,T,F&num=c-39/72&td=ALL> xx.xx.201

FAQET E INTERNETIT

Forma e citimit të tekstit të marrë nga faqet e internetit duhet të bëhet si në vijim:

MBIEMRI, Emri, Titulli. Data e botimit në faqen e internetit. URL: ____, xx.xx.2013 (data e klikimit të linkut në internet prej nga është marrë)

Shembull:

GRAFIKAT DHE FOTOT DHE ILUSTRIMET

Të gjitha grafikët, fotot dhe ilustrimet duhet të vendosen mbi grafikë, foto apo ilustrim si për shembull Foto 1: Ndërtesa e qeverisë së Kosovës, burimi prej nga është marrë

FORMA E PUNIMIT TË DIPLOMËS

FORMA E PUNIMIT TË DIPLOMËS

Faqja e parë

Në faqen kryesore të punimit të diplomës i cili është i mbështjellur me mbështjellës të fortë duhet të shënohet me shkronja të argjendta në krye KOLEGJI ESLG. Në mes duhet të vendoset me shkronja të mëdha TITULLI I TEMËS SË DIPLOMËS. Mëpastaj vjen me shkronja të mëdha TEMA E DIPLOMËS. Madhësia e shkronjave në faqen e parë është Arial 14, përpos titullit të temës së diplomës që është Arial 16.

Shembull:

KOLEGJI ESLG
TITULLI I PUNIMIT TË DIPLOMËS
TEMA E DIPLOMËS BACHELOR
EMRI DHE MBIEMRI

VENDI, VITI

Faqja e parë pas asaj të mbështjellur me mbështjellës të fortë

Shembull:

KOLEGJI ESLG

TITULLI I PUNIMIT TË DIPLOMËS

PUNIMI I DIPLOMËS

Kandidati/-ja: Emri dhe mbiemri

Numri i dosjes:

Programi i studimeve:

Mentori: prof. dr. Emri dhe mbiemri

Vendi, viti

Shkronjat

1 KAPITULLI 1, SHKRONJA 14, SHKRONJAT E MËDHA, BOLD

1.1 TITULLI I NËNKAPITULLIT TË PARË, SHKRONJA 12, SHKRONJAT E MËDHA, BOLD

1.1.1 Titulli i nënkapitullit sekondar, Shkronja 12, shkronjat e vogla, bold

1.1.1.1 Nënkapitulli i tretë, shkronja 12, shkronjat e vogla, bold, italic

Më 20.08.2019 në Prishtinë

Prof. Dr. Edmond Hajrizi



